



## **AKTI I THEMELIMIT**

### **I**

## **SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI" SH.P.K.**

Themeluesit qe firmosin me poshte:

1. ing.Irakli Dine Dinaj, lindur ne Patos me 22.06.1959, dhe banues ne Tirane, me adrese Rr "Aleksander Moisiu", pall.40, ap.22.
2. ing.Artan Namik Mukli, lindur ne Berat me 17.04.1963, dhe banues ne Tirane me adrese, Bulevardi "zogu i Pare", Rr "Haxhi Dalliu", pall.nr.1.
3. Prof.Dr.Bashkim Ramazan Çela, lindur ne Tirane me 07.04.1952, banues ne Tirane me adresen Rr "Kongresi i Manastirit".
4. Prof.Dr.Riza Muhamet Aleti, lindur ne Shkoder me 15.01.1953, banues ne Tirane me adrese Rr "Siri Kodra", nr.44/4.

Qe ne vijim do te quhen **Ortake**,

Sot me date 05. 01. 2006, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", vendosen te themelojne Shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

### **Kreu I**

## **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

### **Neni 1**

#### **Objekti i shoqerise**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarise e saj ne fushen e :

- Shpimi i puseve te te gjitha llojeve (nafte, gaz, uje, perforcues, studimore hidrogeologjike, gjeologo-inxhinjerike).
- Kryerje te punimeve minerare te te gjitha llojeve, (galeri nentokesore, karriera etj.) dhe perforcimi i tyre.
- Monitorim, mbikqyrje e kolaudim te gjithe llojeve te punimeve per shpimin e puseve dhe punimeve minerare.
- Monitorime, per ndotjen e mjedisit (mjedis urban, minerar, industrial etj)
- Studime per ndotjen e mjedisit, (mjedisit minerar, urban e industrial).

- Hartimi i projekteve per shpimin e te gjitha llojeve te puseve.
- Hartimi i projekteve per kryerjen e te gjitha llojeve te punimeve minerare.
- Konsultime per te gjitha problemet teknike dhe teknologjike ne lidhje me shpimin e puseve dhe te punimeve minerare.
- Kryerjen e studimeve ne fushen e mekanikes se fluideve.
- Oponenca studimesh dhe projektesh ne fushat e shpimit te puseve dhe punimeve minerare.
- Monitorim, mbikqyrje dhe kolaudim te gjitha llojeve te punimeve per shtim dhe asfaltim rruges, trashese etj.
- Monitorim, Mbikqyrje dhe kolaudim te te gjitha veprave te artit kanalizim ujesjellesash etj.

## **Neni 2**

### **Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne: **“STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI” sh.p.k.**
2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rruga e Kavajes, perballë ambulances nr.9, Tirane.
3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni 3**

### **Rregjimi juridik**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
2. Me vendim te saj, Asambleja e Ortakeve mund te ndryshoje rregjimin juridik te Shoqerise, neqoftese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e

shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 (dhjete) vjet.

**Kreu III**  
**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

**Neni 6**

1. Kapitali themeltar eshte 100 000 (njqind mije) Leke.
2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte:

Irakli Dine Dinaj me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.  
Artan Namik Mukli me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.  
Bashkim Ramazan Çela me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.  
Riza Muhamet Aleti me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.

**Kreu IV**  
**ORGANET E SHOQERISE**

**Neni 7**

Vendimet ne Shoqeri merren nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar caktohet nga Asambleja e Ortakeve.

**Kreu V**  
**ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise.
2. Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.



**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

STUDIO PROJEKTIMESH, STUDIMESH, MONITORIMESH "ARBI" sh.p.k.

Ing. Arakli Dine

ing. Artan Mukli

Prof. Dr. Bashkim Çela

Prof. Dr. Riza Aleti

*Arakli Dine*  
*Arakli Dine*

*Artan Mukli*  
*Artan Mukli*

*Bashkim Çela*  
*Bashkim Çela*

*Riza Aleti*  
*Riza Aleti*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 770 Rep.

Nr. 21 Kol.

Tirane me 03.04.2006

**VËRTETIM**

Në Tiranë, sot më datë 03.04.2006 (dymijë e gjashtë), para meje noteres, u paraqitën personalisht zotërinjtë:

Arakli Dine, Artan Mukli, Bashkim Çela dhe Riza Aleti, në cilësinë e themeluesve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar studio private PROJEKTIMESH, STUDIMESH, MONITORIMESH "ARBI", për identitetin e të cilëve u sigurova nga dokumentet identifikues që ata mbanin, të cilët deklaruan se akti i mësipërm është përpiluar dhe nënshkruar me vullnetin e tyre të plotë e të lire dhe unë noterja bazuar në ligj e vërtetoj.

PULE TAKSE



NOTERE

*Arakli Dine*

*Artan Mukli*

*Bashkim Çela*



**S T A T U T I**  
**I**  
**SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH**  
**ARBI” SHPK**

**KREU I PARE**  
**Pjesa e pergjithshme**

**NENI 1**

Shoqeria tregetare **“STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI” sh.p.k.** formohet nga ortaket themelues:

1. ing.Irakli Dine Dinaj, lindur ne Patos me 22.06.1959, dhe banues ne Tirane, me adrese Rr “Aleksander Moisiu”, pall.40, ap.22.
2. ing.Artan Namik Mukli, lindur ne Berat me 17.04.1963, dhe banues ne Tirane me adrese, Bulevardi “zogu i Pare”, Rr “Haxhi Dalliu”, pall.nr.1.
3. Prof.Dr.Bashkim Ramazan Çela, lindur ne Tirane me 07.04.1952, banues ne Tirane me adresen Rr “Kongresi i Manastirit”.
4. Prof.Dr.Riza Muhamet Aleti, lindur ne Shkoder me 15.01.1953, banues ne Tirane me adrese Rr “Siri Kodra”, nr.44/4.

te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr. 7638 dt. 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregetare” nepermjet Aktit te Themelimit kane rene dakort te destinojne ne nje sipermarrje pasuri te tyre me qellim qe te ndajne fitimin ose qe te mund te perfitojne nga te ardhurat qe rrjedhin prej saj.

**(Forma, emertimi, selia , kohezgjatja)**

**NENI 2**

Shoqeria tregetare eshte e organizuar si shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe do te mbaje emertimin : “Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi” Shpk.

Ortaket e kesaj shoqerie marrin persiper te paguajne pjeset qe u takojne nga humbjet e aktivitetit tregetar ne kete shoqeri.

Ne rast transferimi te veprimtarise tregetare mund te ruhet i njejti emertim me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

### **NENI 3**

Shoqëria tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk. do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat mbi 10 vjet.

### **NENI 4**

Shoqëria tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk. ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranës, Rruga e Kavajës, përballë ambulancës nr.9.

Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregëtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregëtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Njesitë strukturore të shoqërisë në format e mesipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e vet.

Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

### **NENI 5**

Shoqëria tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk. fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e Shkalles së Parë Tiranë në Regjistrin Tregëtar pranë kësaj gjykate.

Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të nevojshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin sipas pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.

### **NENI 6**

Shoqëria tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk. do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat mbi 10 vjet.

- Shpimi i puseve te te gjitha llojeve (nafte, gaz, uje, perforcues, studimore hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinjerike).
- Kryerje te punimeve minerare te te gjitha llojeve, (galeri nentokesore, karriera etj.) dhe perforcimi i tyre.
- Monitorim, mbikqyrje e kolaudim te gjithe llojeve te punimeve per shpimin e puseve dhe punimeve minerare.
- Monitorime, per ndotjen e mjedisit (mjedis urban, minerar, industrial etj)
- Studime per ndotjen e mjedisit, (mjedisit minerar, urban e industrial).
- Hartimi i projekteve per shpimin e te gjitha llojeve te puseve.
- Hartimi i projekteve per kryerjen e te gjitha llojeve te punimeve minerare.
- Konsultime per te gjitha problemet teknike dhe teknologjike ne lidhje me shpimin e puseve dhe te punimeve minerare.
- Kryerjen e studimeve ne fushen e mekanikes se fluideve.
- Oponenca studimesh dhe projektesh ne fushat e shpimit te puseve dhe punimeve minerare.
- Monitorim, mbikqyrje dhe kolaudim te gjitha llojeve te punimeve per shtim dhe asfaltim rruges, trashese etj.
- Monitorim, Mbikqyrje dhe kolaudim te te gjitha veprave te artit kanalizim ujesjellesash etj.

#### **NENI 7**

Shoqeria tregtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

#### **(Kapitali)**

#### **NENI 8**

Shoqeria tregtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk do te filloje veprimtarine e saj me nje kapital themelues prej 100 000 leke



Pjesëmarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte :

Irakli Dine Dinaj me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.

Artan Namik Mukli me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.

Bashkim Ramazan Çela me 25% te kuotave te kapitalit themeltar.

Riza Muhamet Aleti me 25% te kuotave te kapitalit themeltar

Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta vlera nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel me e vogel se 1000 leke. Vlera nominale e nje kuote eshte 1000 leke.

#### **NENI 9**

Ne baze te kapitalit themeltar te shoqerise fitimi do te ndahet ne menyre te ne baze te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **NENI 10**

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregetar.

#### **NENI 11**

Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i çdo fondi te vecante percaktohen nga organi administrativ sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.

Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci I miratuar nga Asambleja e Ortakeve do te shpërndahen si vijon : 5 % për fondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar; pjesa tjetër ndahen midis ortakeve te kesaj shoqerie ne raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

#### **NENI 12**

Shoqeria tregetare "Strati Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh" do te funksionojte ne menyre te zakonshme te kompanive te tregut dhe

disponon ate ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

Te gjitha shpenzimet per ushrimin e aktivitetit tregetar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

### **NENI 13**

Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.

Aktiviteti financiar I shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.

Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta te hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

### **NENI 14**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te trasnferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

### **NENI 15**

Ne rast mospranimi pjeset e kapitalit themeltar mund tu trasnferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e shumices se qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar te ortakeve ose shihet mundesia e blerjes se tyre nga shoqeria, per tu anuluar

Pjeset e kapitalit themltar jane lirisht te trasnferueshme ndermjet ortakeve te kesaj shoqerie.

## **NENI 16**

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre apo zvogelimi i tij behet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel I autorizuar dhe me kerkesen qofte edhe te njerit prej ortakeve themelues.

## **KREU I DYTE**

### **Ortakeria**

## **NENI 17**

Ortakeria per shoqerine tregtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk krijohet dhe mbeshtet ne Aktin e Themelimit te kesaj shoqerie dhe ne ligj.

## **NENI 18**

Votat e ortakeve kane vlere proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Çdo kuote ka te drejten e nje vote. Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamble nepermjet nje ortaku tjetër ose nepermjet nje perfaqesuesi, duke u pajisur keta me prokure te posaçme dhe te marrin vendime per ato çeshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Ortaku nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtës të votojë në emër të një pjese të kapitalit të tij themeltar duke votuar ai vetë në emër të pjesës tjetër të kapitalit të tij themeltar.

## **NENI 19**

Ortaket e shoqerise tregtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise, ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e shoqerise.

## **NENI 20**

Të drejtat dhe detyrat e ortakëve :

- Te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese duk ushtruar te drejten e votes se tij
- Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise
- te informohet mbi permbajtjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekset e vendimeve te propozuara, e raportin e ekspertit kontabel
- te perfitoje nga fitimi I shoqerise ne raport me kuatat zoteruse prej tij
- cdo ortak mund te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara

## **KREU I TRETE**

### **Organizimi I shoqerise**

## **NENI 21**

Shoqeria tregtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk ka si struktura drejtuese :

- Asamblene e Ortakeve
- Administratorin

## **NENI 22**

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres I shoqerise

Ne perberje te kesaj asambleje perfshihen ortaket e shoqerise, pavaresisht nga pjesa zoteruese ne kapitalin e shoqerise

Asambleja e ortakeve thirret nga Administratori, eksperti kontabel I autorizuar ose nga ortaket te cilet zoterojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar te shoqerise:

Asambleja e ortakëve të shoqërisë tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk. thirret të paktën një herë në vit.

Lajmerimi bëhet me leter rekomande ose me telegram me lajmerim marrje të paktën 15 ditë para mbledhjes së Asamblesë. Lajmerimi, si rregull, duhet të bëhet nga Administratori dhe duhet të përmbajë rendin e ditës.

Mospjesëmarrja e ortakut të lajmeruar duhet të pasohet me njoftimin urgjent të shkaqeve të mosparaqitjes dhe njoftimin e administratorit për datën e mundshme të paraqitjes. Me këtë rast duhet të respektohet afati I përcaktuar në paragrafin e pestë të këtij neni.

Mosparaqitja pa shkaqe të arsyeshme të ortakut të thirrur përben shkelje të detyrave të ortakut të përcaktuara në Aktin e Themelimit

Vendimet e saj sipas karakterit dhe rëndësisë merren me shumicë të zakonshme, shumicë absolute, me shumicë më të lartë se  $\frac{3}{4}$ , në bazë të kriterit të shumicës së dyfishtë apo me unanimitet.

Çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

### **NENI 23**

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

- Te hartojë e miratojë ndryshimet në Statut
- Te miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
- Te vendosë për zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë
- Te emerojë dhe shkarkojë Administratorin e shoqërisë
- Te shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë
- Te shprehet për kohezzgatjen e shoqërisë
- Te miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj
- Te miratojë strukturat e shoqërisë etj.
- Çdo vendim tjetër që I njihet nga ligji, Akti I Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.

Proces verbalët e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë

## NENI 24

Administrimi I shoqërisë "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk kryhet nga Administratori I cili emërohet nga Asambleja. Administratori mund të jete persona fizikë jashte shoqërisë ose dhe nga ortakët.

Administratori I shoqërisë I emëruar nga Asambleja e ortakeve eshte Detyrat e administratorit janë :

- Të mbikqyrë dhe të kontrollojë gjithë veprimtarinë e shoqërisë
- Të vendosë për problemet që I lindin shoqërisë në periudhën midis dy mbledjeve të Asamblesë në zbatim të detyrave të saj
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, në administratën publike e në organet gjyqësore
- Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që I nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregëtar e ekonomik
- Të paraqes për miratim Asamblese së Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni I punës I Republikës së Shqipërisë.
- Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë
- Të thërrasë Asamblenë e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar
- Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pauses dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Asambleja
- Të informojë me shkrim ortakët për çdo problem që I kerkohet prej tyre në konformitet me ligjin
- Të harroje planet e llogarive ekonomike e ti paraqese ato per miratim ne asamble
- Të pergjigjet me shkrim kerkesave te sse njejtes natyre te bera nga ortaket

## NENI 25

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## **NENI 26**

Shoqëria "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk emëron Ekspert-Kontabël të Autorizuar

Emërimi kryhet nga Asambleja e Ortakëve

Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi I tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

## **NENI 27**

Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi I tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

## **KREU I KATËRT**

### **Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë**

## **NENI 28**

Shoqëria "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk me anë të bashkimit mund ti kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë qe ushtron te njejtin aaktivitet.

Gjithashtu shoqëria "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk me anë të ndarjes mund ti kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që I përkasin shoqërisë që do të krijohet.

Transferimi I plotë I aktivitet të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakëve

**KREU I PESTË**  
**Prishja dhe likuidimi I shoqërisë**

**NENI 29**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore të tjere që nuk varen nga Ortaket.
- 2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakëve emeron një ose disa likuidatore, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre.

**NENI 30**

Likuidimi I shoqërisë tregëtare "Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi" Shpk vendoset nga Asambleja e Ortakëve kur prishet shoqëria

**NENI 31**

Në këtë rast nga Asambleja e Ortakëve caktohet një ose disa likujdues. Likujdimi vendoset nga Gjykata me kërkesën e administratorit. Kërkesa duhet të përmbajë dokumantacionin e parashikuar nga ligji dhe Statuti për rastet e likuidimit.

**NENI 32**

Nëqoftëse Asambleja, për mbylljen e llogarive të likujdimit, nuk mund të marrë vendim ose ajo nuk pranon të miratojë llogaritë e likujduesit, vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likujduesit ose çdo personi i interesuar.

Procedura që duhet të ndjekë Gjykata në këtë rast përcaktohet nga asambleja dhe duhet të gjelë pasqyrimin e vet në Statut në një kohë të



mëvonshme që nga krijimi I shoqërisë, por në çdo rast jo më vonë se 6 muaj nga krijimi I saj.

Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e asamblese zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet I mirëqënë.

### **NENI 33**

Në fund të procesit të likudimit thirret Asambleja e Ortakëve për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **NENI 34**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve zgjidhen me mirëkuptim.

Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen në rrugë administrative secili prej ortakëve ose cdo person I interesuar ka të drejtë ti drejtohet për zgjidhje Gjykatës Shkallës Parë Tirane

### **NENI 35**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Për Shoqëritë Tregëtare si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

### **NENI 36**

Ky Statut përpilohet në 4 shtate kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore.

Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë